



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:041917
Datë: 22.07.2022
Numri i dokumentit: 03258087

C.nr.57/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kundër të paditurës OE NPT “E.” SH.P.K, me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson B. S. nga Peja, për shkak të borxhit, me datë **22.07.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren, **KONSIDEROHET E TËRHEKUR**.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kësaj gjykate i ka ushtruar padi, me datë 16.01.2020, kundër të paditurit OE NPT “E.” SH.P.K, me seli në Pejë, për shkak të borxhit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses Drejtori A. B. me parashtrësë të veçantë prej datës 24.11.2021, ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.57/2020, më datë 22.07.2022

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa e veçantë.